Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguene

RILINDJA

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО:
ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE:
T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Vjeti IV Nr. 143 | PRISHTINE, e ejte 9 Shtatuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

PROTESTE KUNDRA FUSHATES SHPIFSE NDAJ KQ te PKJ DHE VENDIT T'ONE

Rezolucjoni i Keshillit kryesuer te Frontit populluer te Serbis ne lidhje me fushaten e shpifjeve kundra KQ te PKJ

Ne Beograd u-mbajt mbledhja e II-te plenare e Keshillit Kryesuer te Frontit populluer te Serbis. Mbledhjen e hapi sekretari i Keshillit kryesuer Milan Popoviq, i cili, mbassi e proponoi rendin e dites ia dha fjalen shokut Blagoje Neshkoviq. Shoku Blagoje Neshkoviq paraqiti raportin e aktivitetit punes se Frontit populluer te Serbis ne periudhen prej Kongresit te dyte te Frontit populluer te Serbis deri sod.

Mbassi e dha referatin shoku Blagoje Neshkoviq, e muer fjalen Dushan Petroviq-Shane. Ai proponoi qe te perpilohet nji rezolute dhe, njiherit e dha tekstin e saje, te cilin te pranishmit njizanit e pranuen

REZOLUCJON

Keshilli kryesuer i Frontit populluer te Serbis tue shprehe ne tanesi mendimin e ma teper se tre miljonave, anetare te Frontit Populluer te Serbis e gjykon ma se rrepti fushaten shpifse qe e bajne udheheqesat e disa partinave komuniste-puntore dhe disa funksionare pergjegjesa shtetnuer te vendeve demokratike kundra PKJ dhe Komitetit Qendruer te PKJ me shokun Tito ne krye, kunder Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe Qeveris RFPJ, kundra popujve te RFPJ.

Keshilli Kryesuer i Frontit populluer te Serbis shprehe indinjaten e vet kundra fushates se pakuptim, i bindun thele se ajo s'ka kurrfar lidhjeje me qellimin qe te ndihmojne popujt e Jugosllavis ne perpjekjet e tyne per ndertimin e socjalizmit, por, perkundrazi, ka per qellim me sjel ndrejt per se drejti dame, si interesave vitale te popujve te RFPJ, ashtu dhe interesave te popujve tjere qe po ndertojne socializmin dhe mbare levizjes nderkombetare puntore, pune kjo qe damton interesat e Frontit antiimperalist dhe demokratik. Keshilli kryesuer i Frontit populluer te Serbis asht i bindun thellesisht ne rrugen e drejte te politikes dhe qendrimit te Komitetit Qendruer te PKJ ne lidhje me rezoluten e Byros Informative. Komiteti Qendruer i PKJ, edhe ne keto dite me luften e vet per mprojtjen e fitoreve te luftes nacjonal-çlirimtare dhe per ndertimin e socializmit ne Vendin t'one ka tregue besnikin e vet kundrejt Marksizem-Leninizmit.

Keshilli Kryesuer i Frontit populluer te Serbis i thrret te gjitha organizatat dhe te gjithe antaret e Frontit populluer te gjithe njerzit punues te Vendit t'one t'i shtrengojne rradhet e veta ne lufte per kryemjen e detyreve te vjetit te dyte te Planit pesvjeçar, per ndertimin e socializmit, per ngadhnjimin e se vertetes mbi akuzat shpifese

Rrnofte PKJ heroike dhe Komiteti i saje Qendruer me shokun Tito ne krye!

Rrnofte Fronti Populluer i Serbis!

Rrnofte Fronti Populluer i Jugosllavis!

Vendit t'one gjate luftes çlirimtare dhe s'do t'i harrojme gjithashtu edhe mundimet t'ona per ndertimin e socjalizmit.

I thrrasim te gjitha partite motra komuniste te vendeve te demokracis popullore qe t'i ndalin shpifjet anmiqesore dhe akuzat e padrejta kundrejte Vendit t'one, mbassi ato u sjellin dam te gjitha levizjeve perparimtare ne bote.

Tue e shtue edhe ma fort hovin ne pune te palodhshme per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one, na i tregojme mbare botes se nuk shkeputemi kurrsesi prej linjes se socjalizmit".

Miting puntoresh e nepunnesash te tri kolektivave punuese ne Prishtine

PRISHTINE:

Kolekti punojs i sipermarrjes nde limore „Graçanica", t'industris se tullave dhe sipermarrjes per ndertimin e trigeve dhe urave ne Prishtine e kane mbajte se bashku nji miting protestues kundra fushates shpifse, e cila bahet ne vendet e demokracis popullore kundra vendit t'one.

Ne miting, ku mueren pjese afro 1.000 puntore dhe nepunesa prej tri kolektivave punojse, kane fole: Hashim Mustafa, sekretari organizativ i Komitetit te Vendit te PK ne Prishtine dhe Radomir Xhudoviq, sekretar i byros te sipermarrjes ndertimore „Graçanica". Ne rezoluten e prume ne fund te mitingut ndermjet te tjerave thuhet:

"Na, nga ky miting i porcsisim ata qe shpifin per Komitetin t'one Qendruer, per Partin t'one dhe popujt t'one, se pergjegjesija per dobesimin e Frontit demokratik te paqes dhe te liris, per dobsimin e levizjes puntore nderkombtare, bjen krejtesisht mbi ta. Na i porosisim qe te mos largohen prej realitetit dhe fakteve, pse kjo gja asht - tradhti e marksizem - leninizmit.

Na, si ne shej te protestes kundra trenave dhe shpifjeve te tyne do t'i shtrengojme edhe ma fort rradhet t'ona ne kuadrin e klases s'one puntore nen udheheqjen e Komitetit t'one Qendruer, Partis Komuniste te Jugosllavis dhe shokut Tito se do te punojme edhe ma teper ne zhvillimin e garave socjaliste, se do te luftojme edhe ma teper per plotsimin qind per qind te planeve te prodhimit dhe tejkalimin e normave te caktueme.

Nga mitingu puntoret i derguen nji telegram sekretarit te KQ te PKJ Mareshalit te Jugosllavis Josip - Broz Tito-s, ne te cilin i apin fjalen se do te luftojne edhe ma tepe per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one, besnike t'internacjonalizmit, te denje thirrjes se vet komuniste, te vendosun dhe kryenalte, sikurse gjate luftes katervjeçare kundra okupatorit, tradhtarve dhe shtypsave te Vendit".

Te pregatitemi per kryemjen me kohe te mbjelljeve te vjeshtes

Ndodhemi ne pragun e nji detyre me shum randesi para mbjelljeve te vjeshtes. Fushata e sivjeme e mbjelljeve te vjeshtes bahet ne vjetin vendimtar te Planit t'one pesvjeçar, kur detyra e shtimit te produktivitetit bujqesuer dhe perparimi i bujqesis ne pergjithesi paraqitet si nji nga detyrat ma kryesore.

Plani i sivjem i mbjelljeve te vjeshtes ka randesi te madhe per perparimin e ekonomis se mbrapambetun ne Krahinen t'one. Ne krahasim me vjetin e kaluem do te shtohen siperfaqet e mbjelluna ne vjeshte me 6,1 per qind e kjo do te mbrrihet me thyemjen e livadheve, merenave, kullosave dhe me zbulimin e tokave te punueme qe jane ende jasht evidences. Gjithashtu me planin e sivjem parashitet zvoglimi i siperfaqeve qe mbillen ne prandvere me drithna te bardhe dhe shtimi per 12 per qind i siperfaqeve qe mbillen ne vjeshte. Ne vjeshte do te mbillet me grune nji siperfaqe 9 per qind ma e madhe nga ajo e vjetit te kaluem e me theken 14 per qind ma e madhe. Ne vendet malore do te mbillet 190 per qind ma teper tershane se sa ne vjetin e kaluem. Gjithashtu do te shtohen siperfaqet me bimet per ushqimin e bagtis, e sidomos lucerkes do t'i kushtohet nji kujdes i madh ne vendet nder vade sidomos ne Metohi dhe Pomoravle.

Per heren e pare do te fillohet sivjet mbjellja e barishtave gjate vjeshtes, qe do te bahet n'afer 200 hektare. Ne rend te pare do te mbillet spanaku, rrepat e kuq, qepet dhe hudrat. Barishtet ma se shumti do te mbillen ne rrethin e Pejes dhe Prizrenit, ku egzistojne kushtet ma te favorshme. Ne plan gjithashtu, parashitet mbjellja e zarzavateve ne lehe te nxehta n'afersit'e qyteteve.

Tash asht tue u-perpunue plani i mbjelljeve te vjeshtes. Keshillat popullore te vendeve jane te ngarkueme me e perpunue me kohe planin per çdo ekonomi shtepijake ne menyre qe te mos pengohet fillimi i fushates se mbjelljeve dhe mandej zhvillimimi normal i saje, siç ka ngja ne vjetin e kaluem.

Çashtjes se sigurimit te fares i asht kushtue nji randesie veçante. Per shtimin e produktivitetit te fares, Ministrija e bujqesis e RPS i ka dhane Drejtoratit te bujqesis te Keshillit Krahinuer nji sasi fare gruni te klasit te pare, me te cilen do te mundet me u-plotesue nji e pesta e planit te mbjelljeve te grunit.

Kerkesat per fare i kane dergue te gjitha rrethet. Jane marre masat dhe asht perpilue plani operativ i pastrimit dhe plehnimit te fares. Mirepo, ndihet mungese per maqina pastrimi, mbassi nji sasi e madhe maqinash ende gjindet e pameremetueme.

Pregaditjet per mbjelljet e vjeshtes si dhe vet organizimi dhe udheheqja e punes se mbjelljeve jane detyre te mdha dhe te randesishme. Duhet me e krye sa ma pare lidhjen e kontratave per siperfaqet qe do te lavrohen e mbillen nga ana e stacioneve te maqinave; me i meremetue te gjitha maqinat, me sigurue karburantat, me organizue pastrimin sa ma te shpejte te fares dhe me i krye ne kohen e duhun te gjitha pregatitjet organizative dhe teknike, ne menyre qe mbjellja te bahet pa pengesa. Dihet se te gjitha keto detyre nuk mund t'i kryejne vetem keshillat popullore te vendeve. Ketyne u nevojitet ndihma e plote e organizatave te Partis dhe organizatave tjera popullore, e sidomos kur te merren parasyshe kundershtimet nga ana e pasanikve te katundit. Prandaj asht e domosdoshme me e mobilizue katundarine punuese, katundaret e vobeget dhe te mesem, ne lufte kundra çdo orvajtjeje per te pengue realizimin e plote te planit dhe perparimin e zhvillimin me plan te bujqesis s'one.

Populli i Gjakoves proteston kundra shpifjeve qe i bahen KQ te PKJ

Me daten 4 te ketij muej n'ora 8 s-ba ne Gjakove mitingu i madh me rasen e formimit te brigades se punes, e cila ka per qellim qe te rindertoje qytetin. Perveç brigades fillim te sheshin e kales „Lirija" edhe nji mase e madhe populli prej ma se 1.500 vetesh dhe 100 qere per pune.

Mitingun e hapi shoku Fadil Ramadani i cili iu drejtue popullit tue ia shpjegue randesin e formimit t'asaje brigade. "Brigada-tha shoku Ramadan, asht e perbame prej 6 çetash, te cilat kane nga 150 vete dhe do te punoje çdo te diele. Kjo menyre pune ka me i dhane rase te gjithve me punue, e jo disa t'apin ma shum e disa hiç. Mbas shokut Ramadan e muer fjalen shoku Nexhmedin Kuçi, Sekretar i Frontit te rrethit te Gjakoves i cili ne lidhje me punen qe bahet sot ne te gjithe Jugosllavin e re, bani nji perskkrim te shkurter te historis se shkelqyeshme te P.K.J., si frymezuese kryesore e te gjitha fitimeve qe kemi korre, qofte kundra okupatoreve, dhe vendasve, tradhtarve etj., qofte ne ngritjen ekonomike-shoqnore-politike t'Atdheut t'one. Mandej, tue kalue n'akuzat, qe pa te drejte i veshen KQ te PKJ nga vendet demokratike, shoku Kuçi tha." Na jemi tue e zbatue besnikisht Socjalizmin ne gjithe kete, disa Parti Komuniste na akuzojne se e kemi lane rrugen e Marksizem Leninizmit, por na e kemi thane dhe e themi se keto akuza nuk i pranojme; per kete fiet lufta e jone ne zbatimin e vendimeve, ma pare, dhe detyra e jone ne ndertimin dhe ndertimin per kete fiet realizimi i perdo-[illegible]

shem i Planit t'one pesvjeçar. Na jemi te sigurte per kete. Kongresi i Peste i PKJ na ndriçon udhen per te ardhmen, drejte se ciles populli e Jugosllavis ecin me hapa te sigurta. Popujt t'one s'i ndane gju prej Partis s'one Komuniste heroike, prej shokut Tito.

Na si pergjegje t'akuzave do te bajme ç'mos qe njerzit t'one t'i organizojme ma se miri rreth Frontit t'one per realizimin sa ma shpejte te Planit pesvjeçar e njikohesisht me i qerue te gjithe ata elementa zakeqij, qe kerkojne, nden maske me minue punen t'one".

Mbas shokut Kuçi e muer fjalen shoku Milutin Feliq, i cili tue fole rreth akuzave, shtoi: "akuzat neve nuk na pengojne aspak ne rrugen drejte socjalizmit". Ne fund shoku Mitar Cana proponoi derginin e nji telegrami KQ te PKJ, i cili u-pranue njizanit nga te gjithe

* * *

Ne telegramin qe i drejtoi nga mitingu populli i Gjakoves Komitetit Qendruer te PKJ, nder te tjera thuhet:

"Na i kundershtojme te githa shpifjet e perhapuna nga vendet demokratike per Vendin t'one, te cilat ne mund t'i pritshim vetem prej shtetesh imperialiste.

Na nuk i harrojme kurre sakrificat e perpjekjet e mdha te popujve te

Filloi nga puna kursi bujqsuer ne Ferizaj

Para pak ditesh, filloi puna ne kursin bujqesuer te hapun rishtas ne Ferizaj prej bashkimit kooperativ. Ne kurs marrin pjese 23 ndjekesa, te cilet mesojne shtate ore ne dite, e perveç landve tjera edhe rregullcret e kooperativave bujqetore. Puna ne kurs do te zgjate njizet dite. Ne mbarim te mesimeve prej tyne do te caktohen pergjegjesa bujqesije nder shtepijat kooperative.

Nder kursista shquhet Angjelko Milenkoviq, i cili tue e njofte mire edhe gjuhen shqipe, mbas çdo theme a tigjitate u ndihmon kursistave shqiptare ne te spjeguemit etj. Perveç mesimeve, ne kurs lexohet edhe shtypi pergjithesisht

R. S.

Mitrovice:

Ne sipermarrjen "Trepça" jane mbajte provimet per pranim regji t... ne klasen e pare te teknikeve punt...

Provimet per ... te cilet i kane ndjeke kursin pregaditor jane mbajte ne gusht. Prej sipermarrjes "Trepça" jane pranue per provim 57 puntore te kualifikuem.

Ne Peje u-formue brigada e I-re e Frontit populluer Ramiz Sadiku

Keshilli i Frontit populluer i rrethit te Pejes perpara disa diteve ka pare fillue fushaten per formimin e nji brigade. Antaret e Frontit ma te ndergjegjshem, tue kuptue randesin e saje dhe dobin qe mund t'i sjellin kolektivitetit t'one, u-paraqiten menjihere. Keta dijten me çmue fort mire se efekti i punes se tyne ka me lujte nji rol me randesi per permbushjen e planit te sipermarrjes "Rugova".

Plani parashihte 220 brigadista kurse qysh diten e pare, me 2 shtator u-nisen 227 vete. Pritet qe te paraqiten edhe te tjere.

Sipermarrja i ka marre te gjitha masat e nevojshme, qe t'u sigurojë puntorve nji jete ma te mire e ma te rregullt. Me kohe i ka pregatite barakat hygjenike, ka sigurue gjithoren me enet e duhuna. Kë[lli] [illegible]

Lufta per socjalizem ne Jugosllavi dhe Kongresi i Peste i PKJ-s

Fjalimi i shokut Millovan Gjillas i mbajtun me nji shtatuer ne mbledhjen e aktivit te Partis te Divizionit te Dyte proletar

Shoke,

Tue ju paraqite raportin mbi punen e Kongresit te Peste te PKJ-s, do te ndalem vetem ne disa çashtje, te cilat jane shtrue dhe ndriçue ne Kongres. Shoket e tjere te Byros se KQ te PKJ, ne raportet e veta, para organizatave qe i kane ngjodhe, do te flasin edhe per çashtjet tjera. Çashtjet qe do t'i ceku une jane keto: e para, mbi kushtet dhe rruget e ndertimit te socjalizmit ne Vendin t'one, me thane ma mire-mbi pengesat qe qendrojne ne rrugen e ketij ndertimi dhe, e dyta mbi ndertimin e njeriut te ri, njeriut te socjalizmit ne Vendin t'one.

Por, para se te kaloj ne keto çashtje, me lejoni qe t'i ceku shkurtimisht disa momente qofte edhe ma te pergjithshme mbi punen e vet Kongresit dhe mbi randesin e tij per Partin t'one dhe Vendin t'one, si dhe per levizjen puntore ne pergjithesi.

Ngjarja ma e madhe ne jeten e mbrendeshme te Partis s'one, qe i prin Kongresit te Peste ka qene siç dihet, konferenca e peste e PKJ-s, e mbajtun ne vjeshten e vjetit 1940.

Konferenca e Peste e PKJ-s u-mbajte ne periudhen e mbarimit te luftes s'ashper dhe te rande per konsolidimin e mbrendeshem te Partis, i e ze ludhen e pregatitjes se Partis per luftnat imminente vendimtare kundra pushtuesave te huej dhe borgjezis se mbrendeshme tradhtare, ma mire me thane-te luftes per pushtetin e popullit puntor.

Puna e Konferences se Peste u-zhvillue ne periudhen e invazionit te fashizmit gjerman, ne periudhen kur imperjalizmi gjerman kishte haptazi per qellim-pushtimin e hegjemonis botnore, kur pregatitej me e sulmue Bashkimin Sovjetik.

Periudha qe po e jetojme sot, e ne te cilen asht zhvillue edhe puna e Kongresit te Peste, nuk asht aspak ma e parandesishme, e lufta qe po e zhvillojme dhe qe na pret, nuk asht aspak ma e lehte dhe ma e thjeshte.

Puna e Kongresit te Peste te PKJ asht zhvillue mbas fitimeve dhe suksesave te medha, te cilat i ka mberi Partija ne luften e armatosun dhe ne punen e rindertimit te Vendit ne baza te re socjaliste. Turmat punuese te Vendit t'one te bashkueme ne Frontin popullor, t'udhehequna prej Partis s'one, e murren pushtetin ne duer e eproneisuen ne kete ase n'ate menyre pasunin e borgjezis neper qytete, i murin te gjitha pozitat kyçe ekonomike ne duert e veta dhe ne kete menyre i realizuen te gjitha kushtet themelore per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Prandaj, puna e Kongresit te Peste te PKJ-s u-zhvillue ne kohen e luftes per kryemjen e Planit te pare pesvjeçar, ne kohen e luftes per ndertimin e themeleve te shoqnis socjaliste ne Vendin t'one.

Kongresi i Peste i PKJ-s u-mbajt ne kohen kur fuqit demokratike dhe anti-imperjaliste ne krye me BRSS-n luftojne per perforcimin e paqes, kur se fuqit imperjaliste dhe reakcjonare ne krye me imperjalistat amerikane, punojne ne menyre intensive per pregatitjen e luftes se re, per rezistimin e sotmit botnuer. Kongresi i Peste i PKJ-s u-zhvillue ne kohen kur veçanerisht imperjalistat e kercnojne lirin e popujve ballkanike, e prandaj edhe te popujve te Jugosllavis, si pozita ma aktive dhe ma te fargta demokratike anti-imperjaliste.

Qe, keto jane rrethanat ne te cilat asht zhvillue puna e Kongresit te Peste.

Por ketyne rrethanave duhet me i u shtue edhe nji tjeter me karakter te veçante. Puna e Kongresit te Peste u-zhvillue ne kohen kur Partija — udheheqsija dhe puna e saj — u-sulmue prej partinave komuniste te tjera, sulme qe, simbas pathemeni... dhe metodave te veta, kane qene te pangjashme deri tash, ne historin e levizjes puntore. Puna e Kongresit te Peste u-zhvillue ne periudhen e luftes se Partis s'one kunder perpjekjeve te ceptimit dhe te dobsimit te saje. Keto perpjekje kane rrjedhe sidomos nga bota e jashtme, prej partive te tjera e prej se mbrendshmi prej elementave relativisht te pakte, te pa-shendoshe, anti-parti dhe te demoralizuem.

Kongresi i Peste ka qene manifestim i fuqishem i unitetit te Partis, pergjegje e pa-dyshimt gjithe atyne te cilet punojne per coptimin e Partis s'one dhe te Vendit t'one.

Kongresi i Peste i theksoi kjarte — si ne programin e PKJ-s, ashtu edhe ne vendimet e tjera qe i pranoi e edhe ne pjesmarrjen e referuesve dhe te diskutantave — se ne çfare rruge dhe me çfare rritmi duhet te zhvillohet. Shkurt, kjo udhe, ashtu siç e pershkroi Kongresi i Peste, permblidhet ne keto tri karakteristika.

Karakteristika e pare. Vendi i jone po transformohet me nji ritthem te shpejte nga vendi relativisht i mbrapambetun, e kryesisht bujqsuer kapitalist ne vend perparimtar industri[a]l dhe bujqsuer socjalist. Kur asht fjala per ritthmin e zhvillimit, mbasi na zhvillojme ekonomin me plan d. m. th. — mbassi e udheheqim me plan ekonomin, mundemi me thane per afersisht me siguri se kur ne Vendin t'one te jete zhvillue industrija, se kur ne te do te fitoje definitivisht socjalizmi.

Ne kete Pesvjeçare te pare, domethane deri ne fund te vjetit 1951, Vendi i jone do te bahet industrijalisht aq i fuqishem dhe i zhvilluem, ne te do te bahen aso ndryshimesh te mbrendeshme shoqnore, sa qe do te realizohen ne te gjitha kushtet qe e likuidohen klaset antagoniste dhe te realizohet rregullimi socjalist i shoqnis.

Por transformimi i Vendit t'one ne drejtimin e permendun bahet edhe sot dhe do te bahet gjithnji ma me fuqi gjate kesaj Pesvjeçare. Shoke, na nuk ngrejme çfardo industrije, por industrin socjaliste, industrin e cila asht prone e popullit. Na nuk mkambim bujqesi çfardoshit, por kooperativizmin ne te gjitha format e tij, ne te cilin jane mbledhe katundaret e mesem dhe te varfen, mandej e ndihmojme zhvillimin e kooperativave te punes, e ndihmojme me te gjitha mjetet katundarin punuese dhe i kufizojme elementat kapitalista ne katund.

Prandaj, ne kushtet t'ona rritja e fuqive prodhuese, zhvillimi i industris dhe perparimi i bujqesis jane identike me rritjen e fuqive socjaliste, me ndryshimin e marredhanjeve shoqnore, me ndertimin e socjalizmit dhe shoqnis socjaliste.

Nenkuptohet, s'ka dhe s'mund te kete fitim te plote te socjalizmit pa likuidimin e eksploatimit, pa asgjasimin e proçes kapitaliste. Me fjale tjera, nuk ka fitim te plote te socjalizmit per derisa t'egzistojne elementat [e] eksploatues ne katund, per derisa ne katund te sundojne keto marredhanje, nga te cilat munden me u-zhvillue marredhanjet kapitaliste, me linde kapitalista.

Prandaj, nuk asht aspak gja e rastit qe Kongresi i Peste kujdes te veçante i ka kushtue çashtjes katundare çashtjes se luftes per transformimin socjalist te katundit. Ne kete pikpamje Kongresi i Peste e ka caktue kjarte vijen e ardhshme te Partis. Kjo vije permblidhet sidomos ne kete: trasformimi socjalist i katundit do te bahet vetem ne baze vullnetare te katundaris punuese. Ne pikpamje te perfshimjes se katundaris punuese ne kooperativa vlene vetem — t'a quejme keshtu — bindja ekonomike, domethane, bindja e katundaris se vorfen dhe te mesene me masat praktike ne dobi te perfshimjes se tyne ne kooperativa te llojeve te ndryshme. Masat administrative dhe te tjerat ketu veç cka mund te jene te dameshme dhe e ngadalsojne te tane procesin. Duhet te theksojme se transformimi socjalist i katundit asht proces relativisht i gjate. Por, nenkuptohet, ai s'asht i gjate ne menyre te pa kufishme, sikurse dishrojne me e theksue oportunistat e ndryshem ne partit tjera komuniste, te cilet edhe ashtu na kane „kritikue" qe na nuk dishrojkemi kursesi me e krye trasformimin socjalist dhe se qenkemi pajtue me kullaket. Si karakteristike te ketij procesi ke na duhet te theksoj kete: qysh tash, ne kooperativat t'ona bujqesore, te cilat ma teper kane karakter shit-blemes, çfaqin jo vetem forma kolektive te punes (veprime te llojeve te ndryshme punuese dhe te tjera), por edhe prona kolektive ne toke e me mjete per prodhim. Katundaret nga kooperativat fillojne te punojne si toke te perbashket utrina te ndryshme, toke djerre etj. Kjo ka randesi te veçante praktike edukative per katundaret. Prona kooperative dhe punimi i tokes do te rritem krahas me bindjen e katundarve punues per nevojen qe te rrnojne ne menyre te re, te denje per njerez, krahas me mundesit e shtetit socjalist me e furnizue katundin me teknike dhe me kuadra.

Tue i pase parasysh te gjitha keto, na qysh sot mundemi me thane se gjate Pesvjeçares se pare jo vetem qe do te pregaditet transformimi i plote socjalist i Vendit t'one, e prandaj edhe i katundit, porse do te perpiqojme mjaft ne rrugen kah ky transformim i plote. Me fjale tjera, na qysh ne mbarimin e kesaj Pesvjeçareke do te kemi jo vetem industrin socjaliste te fuqishme, kuadrit qe ta baje te mundun zhvillimin e mabit'eshem normal dhe te pa-trazueshem te Vendit ne te gjitha drejtimet, por njikohsisht do te kemi edhe sektorin e fuqishem socjalist ne bujqesi.

Prandaj, momenti karakteristik i trasformimit t'one, siç e ka pershkrue Kongresi, asht — realizimi i shpejte dhe gradual i socjalizmit.

Karakteristika e dyte. Ne lufte per transformimin socjalist te Vendit t'one na kemi ndeshe ne pengesa, te cilat nuk kemi mujte me i parapa. Keto pengesa — por jo vetem keto — kryesisht jane te nji natyre morale politike. Sikurse e dini, keto pengesa — te themi — permblidhen ne kritiken, e cila ka fillue me letrat e KQ te PK (b) te BRSS dhe me rezolucjonin e Byros Informative e, cila ne disa vende, si p. sh. ne Rumani, Hungari, Shqipni etj, asht transformue ne nji fushate te çuditshme shpifse dhe ne bojkotimin e organizuem e te gjithanshem te Jugosllavis se re.

Prandej, vija karakteristike e luftes s'one per ndertimin e socjalizmit qendron ne faktin se ky ndertim ndeshe ne mosmarreveshtjen e disa udheheqsave te vendeve demokratike dhe qe levizjet komuniste zyrtare e pengojne ne vend qe ta ndihmojshin.

Por lufta e jone per ndertimin e socjalizmit s'asht diçka e re ne pikpamje theorike, as qe domethane zbulim i nji legjislature te re ne zhvillimin e socjalizmit edhe pse na pengojne disa udheheqsa te partive komuniste. Sikurse kurrkush nuk mundet me vertetue me fakte boshe se ne Vendin t'one nuk ndertohet socjalizmi — sepse per kete s'jane kriter pohimet e tyne, por jeta reale, gjithashtu do t'ishte e padrejse me vertetue — per shkak se ke na ndertimi i socjalizmit shkon me nji ritthem tjeter dhe me rrethana tjera — se jane ndryshme ligjet e ndertimit te shoqnis socjaliste, te cilat i kane zbulue Marksi-Engelsi-Lenjini e Stalini. Rruga, format e zhvillimit, praktika revolucjonare — jane te tjera, por legjislatura e pergjithshme asht e njajte. Ketu nuk ndryshon kurrgja fakti qe tradhtaret e socjalizmit ne Vendin t'one — oportunistat e ndryshem, likuidatoret, trockistat, shpirtvegjelit mikroborgjez, njerzit me ambicje te paknaqshme dhe te pakufishme, llafazanet e ndryshem dhe mekaniket e marksizmit — e luftin punen e tyne antiparti me Rezolucjonin e Byros Informative e bile disa prej tyne ikin ne vendet e demokracis popullore e ne BRSS dhe atje gjejne perkrahje. Para se gjithash, ne mes te ketyne njerzve ka edhe agjenta direkt te shteteve imperjaliste, te cilve tash i u dha mundesija qe te maskohen me rrobe „revolucjonare" dhe „prosovjetike". Por, une nuk flas per te tille, por per ata te cilet ndoshta nuk jane ba ende formalisht, e te cilet meshefen mbas BRSS, Rezolucjonit, marksizem-lenjinizmit etj. Por, per kah esenca, ne mes te parve dhe te dyteve — nuk ka kurrfare diference. Si keta edhe ata luftojne kundra socjalizmit ne Jugosllavi dhe gjejne peshk n'uje te trubullte te detit te shqetsuem socjalist. Ne qofte se i shiqojme Petriçeviqasit, Vllada Dapceviqat, Llalla Ivanoviqat, Dragilet e ndryshem e te tjere, shohim se keta antinjerzore — ne qofte se disa prej ketyne nuk e kane ba kete — do t'ishin ba agjenta dhe informator te shteteve imperjaliste ne çdo situate te veshtire, ne çdo situate, ne te cilen, per te qendrue deri ne fund, asht e nevojshme trimnija e pashterrshme dhe besimi i pashterrshem, te cilen e ka dhe mund ta kete vetem klasa puntore si klase, e prej disave vetem revolucjonare te vertete e te ndershem. Por, keta emigrues dhe degjenerues te ndryshem, simbas te kalueses dhe karakterit te tyne jane te tille, qe munden me qene spijuj te çdo kujt dhe persona t'emigruem ne çdo vend qofte. Nenkuptohet, nuk asht gja e rastit qe ne mes te ketyne na mbas betimit nuk ka komunista te sprovuem e besnik. Perveç kesaj, tradhtine e vet ata nuk munden me e arsyetue me asgja, sepse ata e tradhtojne socjalizmin ne vendin e vet. Nuk ndryshon asgja fakti qe ata punojne nen influencen ose simbas fjaleve nga vendet e tjera socjaliste. Ne realitet, ata nuk mund te pajtohen me kete ritthem te shpejte te ndertimit socjalist ne Vendin t'one, me ket qendrim te papajtueshem te Komitetit t'one Qendruer, te Partis s'one dhe popujve t'one ne çashtjen e ndertimit te socjalizmit ne Vendin t'one, ne ta asht zgjue shpirti pronar kapitalist dhe ata kerkojne dalje nga situata „e veshtire" (per ta!) dhe e „pa-perspektive" (prap per ta!), tue e mshefe relativisht ne menyre te lehte larginin e tyne nga populli dhe tradhtine e vet ndaj vendit tue u-bashkue me Byron Informative dhe deklaraten si ndeques besnik te marksizem-lenjinizmit, internacjonalista, miq te BRSS (me gjithse ne realitet BRSS per ta asht vetem shtet i madh, te cilin ne realitet nuk e duen dhe i cili i interesoi vetem se ai ne situaten aktuale nuk pajtohet me udheheqsin t'one te Partis, e cila i jep hov ndertimit te socjalizmit).

Domethane, ndertimi i socjalizmit ne Vendin t'one ndeshe kryesisht ne te njejtat veshtiresi, ne te cilat ka ndeshe edhe ne Bashkimin Sovjetik, domethane, perveç rezistences relativisht te hapet, elementat kapitalista baj ne edhe rezistence dyftyreshe te maskueme, kryesisht me anen e njerezve, te cilet ne menyra te ndryshme e ne periudha te ndryshme te luftes jane fute ne rradhet e levizjes puntore dhe demokratike. Keta jane trockistat dhe buharinistat t'one. Pra, legjislatura e pergjithshme asht e njejte si ne BRSS e do te jete e tille edhe ne vendet e tjera kur marrin kursin e vendosun dhe jo dymendesh kah socjalizmi, por manifestimi i kesaj legjislature asht ndryshej. Ne Vendin t'one-per shkak te ritthmit te shpejte te ndertimit socjalist (mbani ne mend: ne vjetin e dyte mbas lufte-pa komunizmin luftarak, pa periudhen e gjate te rindertimit-na e kemi parapa dhe kemi fillue me realizue planin Pesvjeçar, i cili e çon vendin direkt ne pragun e shoqnis se re socjaliste) zhvillohet ne te shpejte edhe lufta e mbrendshme politike. Ket ritthem mundemi me e dhane na, se pari per shkak te strukturez se mbrendshme ekonomike te Vendit t'one, se dyti, per shkak te fuqis[?] se naltee te turmave t'ona te bashkueme ne Frontin popullor e te cilat jane te gatshme me shkue mbas Partis, se treti, per shkak te pjesmarrjes se pashoqe, rritjes se vazhdueshme te turmave gjithnji ma te reja ne luften per ndertim, se katerti, per shkak te situates nderkombetare (egzistimi i BRSS dhe e nji vargu shtetesh demokratike, si dhe i levizjeve te fuqishme socjaliste dhe demokratike). Prandaj, krahas me rezistencen e hapet t'elementave kapitalista ne qytet dhe katund, karakteristike simbas historis se PK (b) te BRSS per periudhat para luftes vendimtare per ndertimin definitiv te socjalizmit ne Vendin t'one çfaqet edhe rezistenca dyftyrshe po e ketyne elementave mbrenda rradhve t'ona, veçanerisht karakteristike sidomos per periudhen e fitores definitive te socjalizmit.

Karakteristika e trete. Vendi i jone e nderton socjalizmin me fuqit e veta. Me kete une, kuptohet, nuk them se duem dhe dishrojme te bahet njashtu. Qendrimin t'one mbi kete gja e ka caktue krejt kjartazi Kongresi i Peste dhe ky qendrim permbahet me keto: na e ndertojme socjalizmin me fuqit t'ona pse dishrojme t'i zhvillojme fuqit t'ona prodhuese deri ne maksimum, e jo pse nuk do te dishrojshim me i bashkue keto me fuqit socjaliste te vendeve tjera.

Por neve na morret per te madhe edhe se gjoja duem ta ndertojme socjalizmin pa Bashkimin Sovjetik. Per me e skjarue çashtjen e ndertimit te socjalizmit me fuqit t'ona, si edhe çashtjen e rrugen e ndertimit te tij, duhet pa tjeter me spjegue dhe kete çashtje, d. m. th. çashtjen e ndertimit te socjalizmit pa (d. m. th. jasht rrethit shtetnuer) Bashkimin Sovjetik. Kjo çashtje asht theksue ne nji forme indirekte ke kritikuesit t'one (ne nji forme qe ne duem ndertimin e socjalizmit pa Bashkimin Sovjetik e ata gjoja me Bashkimin Sovjetik). Ne lidhje me ket ma pare duhet me i konstatue disa fakte. E para, kurrkush dhe asnjihere nuk i ka thane Partis s'one, ma mire me thane — Komitetit t'one Qendruer, ne lidhje me kete ndonji vend. Prandaj, jemi te detyruem kur te flitet mbi kete gja qe ne pikpamje te fakteve te mbeshtetun ne nji ane ne praktiken e deritashme, e n'ane tjeter n'ato shka flet Lenjini mbi keto çashtje. Nga praktika e deritashme shofim se marredhanjet ekonomike zhvillohen ne baze te tregtis se zakonshme e jo ne baze (siç duhet te bahet) t'afrimit gradual t'ekonomive dhe te njohunis se gjithanshme njena me tjetren te vendeve socjaliste te ndryshme, tue u-kujdesue gjithnji qe ky afrim te bahet ne baze te barazis, d. m. th. me i zhvillue ato fuqi prodhuese ne sejcilen prej tyne, per te cilat ka ma se shumti kondita natyrale e te tjera dhe, kjo njohuni te bahet nga dy anet. Prandej dhe ne kemi qene te detyruem me ba tregti sa ma mire qe te mundemi, pra, sigurisht kemi ba tregti ma dobet se shum tjeret, te cilet ne tregti kane ma teper eksperience. Persa i perket afrimit t'ekonomive dhe njohunis te gjithanshme — asnjihere nuk na kane ardhe, ne kete pikpamje, kurrfare propozimesh serioze dhe jo serioze, edhe ne qofte se ka qene dikush inicjator i punve te ketilla ai ose ka kundershtue se kjo nuk vehet ne zbatim — kjo ka qene Jugosllavija dhe njerzit e saje, te cilet kurre per shembull nuk kane mujte me mendue se per shkembimet ekonomike ndermjet tyne e vendeve socjaliste duhet te vlejne po ato ligje si ndermjet vendeve kapitaliste. Prandaj, praktika nuk na jep dhe nuk ka dhane kurrfare materjali, i cili do te na kthente nga rruga e ndertimit te socjalizmit me fuqinat t'ona. Perkundrazi, praktika na flet se socjalizmi, ne qofte se me te vertete duem me e zhvillue Vendin t'one — duhet ta zhvillojme sa ma teper qe te mundemi, tue mos prite ndihma nga jashte e na faktin se kur do t'i shofin te tjeret princypet e drejta.

(Vazhdon ne faqen e trete)

me te cilat duhet me ba tregti, me t'afrue ekonomit, me u-njohe mi, me nji fjale — ta shohim rrugen e lidhjes s'ekonomiave socjaliste ne nji tanesi.

Praktika na flet qe duhet ta ndertojme socjalizmin sa ma mire qe te mundemi, dhe na kete e kemi ba, e bajme dhe do ta bajme, sepse shkaterrime me te dashte pushteti klases s'ate puntore dhe masave punonjese me qofte se simbas fuqinave te veta nuk e ndertoni shoqnin e re? Ai pushtet do te degjenerohej, me qofte se nuk do ta ndertonte socjalizmin simbas mundesive, ai me te vertete do te kalonte prej demokracis proletare popullore ne republiken e tipit [illegible] borgjez.

Tue fole shpesh here mbi çashtjen e bashkimit t'ardhshem t'ekonominave socjaliste, si edhe shteteve, Lenjini e ka nenvizue qe ky bashkim asht ligji i domosdoshem i zhvillimit, se imperjalizmi krijon parakushtet e krijimit t'ekonomis socjaliste botnore t'unjisueme. Me kete rast Lenjini shpesh here e nenvizonte qe disa forma te zhvillimit, disa veçorina te shtetit e te tjera do te mbaheshin shum kohe dhe ne socjalizem dhe se bashkimi i shteteve socjaliste me doemos duhet te krijohet vetem ne baze vullnetare. Pra, Lenjini thot se bashkimi asht ligj, por ligj i cili krijohet ne baze vullnetare, gradualisht ne forma te ndryshme, d. m. th. ne baze t'aksionit koshjent t'atyne qe bashkohen. Lenjini nuk thote qe nji vend duhet me e prite per ndertimin e vet socjalizmit deri sa te krijohen te gjitha kondita per me u-bashkue plotsisht me ndonji vend tjeter socjalist. Perkundrazi, nga Lenjini del se çdo shtet duhet ta ndertoje socjalizmin sa ma shpejte dhe sa ma mire qe te mundet (sepse keshtu, do te bohet ma i forte kunder kapitalizmit) dhe me kete rast te kerkoje forma qe te realizohet bashkimi. Ne nuk e mohojme Lenjinin. Ne gjithmone kemi qene per ate qe ne baze te Lenjinizmit te vendosen te gjitha çashtjet, qe te gjitha çashtjet te cilat lindin pa pritmas ndermjet shteteve socjaliste te zgjidhen ne baze te diskutimeve te hapta, ne baze te marreveshtjeve. Sepse sigurisht lenjinizmi nuk na mson qe afrimi dhe bashkimi i shteteve socjaliste duhet te kryhet n'ate menyre tue shpife rrena ma te çuditshme dhe me masa te ngjajshme te drejtueme kundra tjetrit shtet socjalist, kundra Partis komuniste dhe qeveris n'ate shtet, tue mobilizue elementat ma negativ „me sigurue" bashkimin e ketille.

Marredhanjet e ketilla na i konsiderojme te padrejta dhe te pa lejueshme. Keto jane marredhanje nga bota e vjeter dhe keto nuk duhet te jene karakteristike per marredhanjet ne mes te shteteve socjaliste dhe per afrimin e tyne.

Asht e natyrshme qe ne lufte per afrimin e shteteve socjaliste — e cila asht pjesa perbase e luftes se popujve kundra imperjalizmit, rroli udhehieqes duhet t'i takoje Vendit ma te forte, Vendit i cili ka shkue ma se largu ne ndertimin e socjalizmit, konkretisht — Bashkimit Sovjetik. Si kurse as ne pikpamje te luftes kundra imperjalizmit, ashtu dhe n'ate pikpamje, na nuk e mohojme as nuk mundem me e mohue rrolin udhehieqes te BRSS. Mosmarreveshtja nuk asht rreth asaj se a e njohim na rrolin udhehieqes te BRSS ne lufte per socjalizem ne bote. Ket rrol mund t'a mohoje ndokush qe nuk kujdesohet per realitetin, per marredhanjet reale te fuqive ne bote. Por ky rrol udhehieqes, siç e kuptojme na lenjinizmin, nuk provohet as nuk perforcohet me faktin se mohohet dhe nençmohet lufta e popujve te tjere. Qe, merremi per shembull Jugosllavin. Tash asht ne mode ne shtypin komunist qe — nen forme te rrejshme te nenvizimit te rrolit udhehieqes te BRSS — te lihet ne heshtje ose te zvoglohet me qellim lufta e popujve t'one. E çka don me thane kjo? Kjo don me thane se popujve t'one t'iu humbet besimi ne fuqit e veta, te shtypet historija e tyne, te vehet ne pozite te shiqueseve pasiv — çka ata s'kane qene kurr, e nuk ka qene asnji popull tjeter — ne luften e madhe te njerzis kundra kapitalizmit. E marksizmi ndertaq na meson se popujt e ndryshem, ne periudhat e ndryshme te zhvillimit, kane luejte rrole t'atilla te cilat e kane shenjtnue e pergjithshem te zhvillimit te ma tutjeshem te gjithe shoqnis njerzore. Keshtu ka qene gjithmone ne histori, pra dhe tash ne lufte per socjalizem. Historija nuk qendron ne nji vend dhe nuk pret qe ndokush t'a baje revolucjonin qe kjo te niset. Askush nuk e ka parapa — ne qofte se levizjene revolucjone te ndryshme te cilat jane shkrue para lufte ne levizjen puntore botnore — se ne Jugosllavi do te bahet qendresa ma e forte kundra okupatorit dhe se Jugosllavija e vogel do te bahet shembull i solidaritetit proletar me Bashkimin Sovjetik dhe shembull se qysh ne luften e armatosun kundra okupatorit t'merret me perdhuni pushteti prej borgjezis trathtare. Pra me gjithate keshtu ka ndodhe. Nji rast i ngjajshem asht dhe me luften çlirimtare ne Kine, dhe me luften civile ne Spanje etj. Per ket arsye mohimi dhe nençmimi i rrolit te disa popujve asht i papajtueshem me materjalizmin historik ne pergjithsi, e veçanrisht me mesimet mbi zhvillimin disproporcjonal te kapitalizmit dhe ne lidhje me te mbi zhvillimin disproporcjonal te revolucjonit proletar. Me shlye dhe nençmue rrolin e disa popujve dhe disa partinave ne lufte per socjalizem — qofte rrolin ne luften direkte per pushtet, qofte ma vone ne lufte per ndertimin e socjalizmit — nuk asht e drejte, e veshtirson direkt afrimin e vendeve perparimtare dhe levizjeve perparimtare, asht karakteristike per boten e vjeter kapitaliste e cila i ndane popujt ne ma te miret dhe ma te keqijt, e nuk kujdesohet per te gjithe konditat konkrete historike, te cilat i caktojne detyrat e percaktueme disa popujve ne periudhat e ndryshme te zhvillimit. Prandaj, ata qe mendojne se perforcohet rroli udheheqes i BRSS n'ate menyre qe nençmohet bje fjala, lufta e Jugosllavis ose e ndonji vendi tjeter, ne te verteten i bajne sherbim te damshem BRSS dhe u apin ushqim imperjalistave qe t'a akuzojne Bashkimin Sovjetik — se ai i nençmon popujt tjere, luften e tyne dhe historin e tyne. Perkundrazi lufta revolucjonare e vendeve tjera asht pjese perbase e luftes botnore, te cilen e ka fillue proletarjati dhe populli rus ne Revolucjonin e Tetorit. Lufta e popujve tjere dhe njoftja e saje e perforcojne poziten, pra dhe rolin udheheqes te Bashkimit Sovjetik, rrol i cili asht krijue ne baze te Revolucjonit te Tetorit dhe te ndertimit te socjalizmit ne te. Por veprohet krejte ndryshe. Karjeristat te ndryshem dhe njerzit me kuptime dhe qellime te dyshimta e nençmojne rrolin e popujve te Jugosllavis per me i justifikue dobesit e veta (e jo te popujve te tyne) ne luften e madhe e vendimtare ne mes BRSS dhe fashizmit.

Prandaj, po e perserit se nuk asht çashtje kundershtimi-persa na perket neve-rolit udheheqes i BRSS dhe i Partis bolshevike, por nençmimi i rolit te popujve te Jugosllavis dhe PKJ, si ne luften Çlirimtare ashtu dhe sot ne luften per ndertimin e socjalizmit ne kete pjese te ruzullit tokesor. Mandej nuk asht çashtje kundershtimi ne se na duem a po nuk duem me e ndertue socjalizmin me Bashkimin Sovjetik ose pa te, por forma, menyra ne te cilen duhet te realizohen dhe te zhvillohen marredhanjet ne mes te shteteve socjaliste-me anen e marreveshtjeve e besimit reciprok a po mosbesimit dhe "sigurimit" me anen e poterave shpifse, frakcjoneve, me anen e nençmimit te rolit te disa vendeve dhe partinave.

Ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one e me fuqite t'ona Kongresi i Peste e ka shtrue si gja te mundeshme. D.m.th. Kongresi i Peste ka konstatue se na kemi mjaft fuqi me e realizue socjalizmin me fuqit t'ona. Por Kongresi i Peste e ka theksue njikohesisht se Partija e jone do te baje çmos çka mvaret prej saje qe ne lufte per socjalizmin te realizohet bashkpunimi i gjithanshem ekonomik dhe bashkpunimi tjeter me BRSS dhe me vendet e demokracis popullore.

Shoke, me kaq kishem ma i dhane fund çashtjes se ndertimit te socjalizmit ne vendin t'one ashtu siç e ka shtrue Kongresi i Peste. Por, mbasi ne lidhje me kete kam fole mbi ata, qe kritikojne (persa trillimet e thjeshta mund te quhen kritike) Partine t'one, me lejoni ti ceku shkurtimisht edhe disa çashtje.

Kongresi i Peste ka tregue shum kjarte se Partija e jone asht tue shkue me gusim drejte rruges se ndertimit te socjalizmit, se asht e shendoshe dhe kompakte dhe se nuk ka frige prej veshtiresive. Kritikuesat t'one kane shpresue se ne Kongresin e Peste do te shkaktohen perçamje e mbasi kjo nuk ngjau, ia kane hye me shpifje si kundra tij ashtu edhe kundra vendimeve te tij. Mbassi nuk munden me e provue asnjenen prej akuzave te tyne, ata jane te shtrenguem dhe do te shtrengohen edhe ma teper me kurdise rrena.

Ne lidhje me kete, po çfaqet si çashtje serioze-çashtja e moralit ne levizjen puntore. Po shtrohet çashtja, a asht e lejueshme me fole te paverteten dhe me perdore rrenen dhe mjetet e tjera te pandershme-mashtrimet dhe provokimet ne levizjen puntore, tue e maskue me sherbimin e nji ideali ma te nalte? Me trathtaret t'one te socjalizmit jane bashkue ne fushaten çpifse kundra Partis s'one dhe Vendit t'one, shum njerez udheheqesa te disa partive fqinje komuniste. Ket fare fushate na nuk mundemi ndryshe me e shique vetem si nji pune jo vetem te pandere, por edhe krejtesisht te dyshimt. Fakti se keta njerez gjinden ne te njajten vije ku jane edhe dezertuesit e ndryshem frakcjonista dhe mikroborgjeze nga fronti socjalist ne Vendin t'one, si qe po i frymzojne dhe po i perkrahin nga te gjitha anet keta dezertuesa, se shtypi imperjalist po e perkrahe fushaten shpifse te shteteve demokratike kundra Partis s'one dhe Vendit t'one, tregon se ketu puna nuk asht e kulluet dhe se gja krejte e natyrshme-ne rradhitjen t'one komuniste asht fute anmiku i klases, i cili don jo vetem me thellue hendekun ndermjet fuqive demokratike, por don me ndihmue dobesimin e Jugosllavis se re, vendit i cili ka qene shembull lufte kundra imperjalistave, shembull i te cilit ka tregue mundesin e luftes se tille te suksesshme dhe mundesin-ne kushtet aktuale-te zhvillimit te socjalizmit edhe ne nji vend te vogel, relativisht te mbrapambetun. Pengimi i ndertimit te socjalizmit ne Jugosllavi, gja qe objektivisht ka per qellim kjo fushate, nuk mundet me mbete pa rrjedhime shum te mdhaja. Te gjithe anmiqet negative, oportunista dhe te maskuem ne menyra te ndryshme, do te dalin ne shesh jo vetem ne Vendin t'one por edhe ne vendet e tjera, ne partinat e tjera. Te gjithe ata mendojne se u ka ardhe koha. Por durimi i yne dhe besimi i yne ne lufte per socjalizmin do t'a zbuloje, ngadalas por pa u-trande, te verteten.

Do te kalojne nji vjet, dy, pese, por na do t'a ndertojme socjalizmin. Athue shka do te thone atehere Rakoshet, Kostovet, Paukeret dhe "kritikuesat" t'one te tjere, te cilet po u dalin zot trathtarve te socjalizmit ne Vendin t'one dhe te cilet kane çpife kundra nesh me aq pa-turpesi sa qe as fashistat nuk kane çpife kundra nesh ne kohen e ofensivave ma te rrebta? Tash ata, per me ia humbe besimin popullit t'one dhe klases s'one puntore, po flasin se si na jemi fantazista, mendjemdhaj dhe avanturjere, se si dehemi me plane ireale. Ket kange mbi avanturizmin dhe irealitetin e planeve na jemi tue ndigjue nga te gjitha anet, qysh prej vjetit 1941. Por, prap se prap ke na asht krejte tue shkue simbas planit. Trave te ngrime u asht duke gjithmone avanturiste dhe e marre çdo gja e re, e keshtu asht puna edhe me luften t'one per socjalizmin. Na do te dalim fitues ne lufte per socjalizem: Athue ku do te shkojne atehere ata qe sot po na akuzojne se si na jemi trockista dhe anmiqe te BRSS, se si kemi ra n'ujdi me imperjalistat dhe se si duem me e ba vendin t'one koloni imperjaliste, se si e kemi trathtue frontin nderkombtar socjalist dhe se jemi ba terrorista dhe kriminela te poshter te tipit hitlerjan? Me shpresue se se paku ne ndonji levizje puntore do te zhduket durimi qe deri atehere t'a ndigjoje kete fushate te çuditshme shpifse, e cila sherben si maske e pershtatshme per tipat e ndryshem te dyshimt dhe prej se cilës deri sot ka pase vetem dame. Sidoqofte, Partija e jone-siç e tregoi ne menyre te [illegible] edhe Kongresi i Peste [illegible] nuk do te shkatrrohet ne ket fushate. Perkundrazi, ajo pa tjeter do te forcohet permbrenda. Do t'i kin dhe do te thyhen oportunistat e ndryshem dhe shpirtevegjelit, te cilet nuk munden me zane rranje serioze ne Parti.

Shoke,

Po ia hye çashtjes se dyte.

Lufta per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one asht njikohsisht lufte per krijimin e njeriut te ri, njeriut, vetedija dhe ndiesija e te cilit do te jene ndryshej nga ato te njeriut te kapitalizmit.

Ky njeri i ri do te jete jo-egoist i sinqert, i gusimshem dhe modest. Per te e mira e popullit, pasunija e popullit — do te jene mbi te gjitha. Qysh tash po çfaqen masovisht njerez te cilet luftojne per ruejtjen e pasunis se popullit, te cilet [illegible] lakmis se grabitjes, mashtrimit dhe vjedhjeve t'imta te çdo llojit. Keta jane njerez te cilet kujdesen per çdo gram e per çdo centim te pasunis se popullit, te cilet, pasunin e popullit e ndiejne si te veten. Njeriu i ri lufton me guxim dhe pa u-trembe per te verteten. Ai asht i papajtueshem kundrejt çdo rrene, çpifje dhe mashtrimi. Ai nepermjet te luftes mesohet se si t'a njofi lehtazi anmikun. Syçeltija e tij, sinqeriteti dhe natyra e tij e çelte i perzane nga rradhet e popullit dhe te Partis te gjithe anmiqet e maskuem dhe dyftyrshat. Qysh tash paraqiten masovikisht njerez te cilet po luftojne me vetedije dhe aktivisht kundra çdo rrene, hipokrizije dhe çdo dyftyrshi, e mbare populli i yne po mbetet i habitun me te pavertetat e pa-shoqe, te cilat, nga te gjitha anet po i hidhen Vendit t'one dhe udheheqsis se tij. Njeri i ri s'do te trembet prej asgjaje ne lufte per socjalizmin, per te miren e popullit te vet dhe Vendit te vet. Qysh tash — ma shum se sa ne luften Çlirimtare — po lindin heroi te ndertimit. Turmat t'ona, me gjithe skamjet e ndryshme, veshtirsinat e mdhaja, me vetmohime te pashembullta dhe heroizmin e pa-shoq po e ndertojne atdheun te vet. Çdo fabrike e re, çdo braze e Vendit t'one asht vadite me djerse te mdha. Nuk duhet as me dyshue se duert qe po krijojne industrin t'one dhe po e mbekambin bujqesin nuk do te dijne me perdore armet po ashtu me zotsi e me guxim dhe me i mprojte fitoret e veta. Nga kushtet t'ona po linde patjeter heroizmi masovik. Modestija asht gjithashtu veti e njeriut te ri qe po krijohet sot ke na. Ai e don popullin dhe vendin e vet, ai i don edhe popujt e tjere e nuk i nençmon. Ai asht i bindun ne fuqit e veta, por me kete besim nuk e nençmon fuqin dhe vleften e njerzve te tjere. Ai nuk ka per qellim me u-dallue personalisht por objektivi i tij asht me fitue çashtja e pergjithshme per te cilen ai lufton. Ai ban gara me qendrueshmeni te pa-shoqe, por jo me fitue fame, por per me fitue çashtja e perbashket, ma ne fund — per me tregue se çka asht ne gjendje me ba vullneti i njeriut dhe qe te tjeret te mesohen prej tij. Ai don qe te zhvillohet mire e ma mire puna ku asht tue punue, edhe ne qofte se mbetet personalisht pa u-dallue, ai asht i vetedijshem se detyra e njerzve asht me punue per te miren e pergjithshme, t'apin shka asht e mundun me qellim qe populli te mundet me jetue sa ma mire dhe sa ma i lumtun. Me ece gjithmone perpara me mesue na pra, me u-zhvillue gjith nji, qe t'i ape sa ma teper komunitetit. Qe ky asht qellimi i njeriut te ri.

Ky njeri i ri po linde te na drejte per se drejti nga beteja per socjalizem. Por proçesi i krijimit te tij nuk asht spontan. Me thane te drejten kete njeri te ri po e krijojne puna, perpjekjet e vetedijshme, vetmohimi, po e krijon vet proçesi i ndertimit socjalist. Por ate, para se gjithash, po e krijon Partija e jone, si nepermjet te ketij ndertimi, ashtu edhe me rrolin e vet edukativ, me punen edukative qe ajo po e kryen ne menyre te ndryshme. Krijimi i njeriut te ri, ne themel asht i vetedijshem, proçes i organizuem. Edhe ketu qendron merita e madhe e Partis t'one por edhe detyra e saje e madhe. Krijimi i njeriut te ri nuk guxon kurrsesi me mbete mbrapa ndertimit socjalist. Njeriut te punes te Vendit t'one, i cili ne themel — si njeri i punes — i ka veçorit e ketij njeriut te ri, duhet me i ndihmue qe keto veti te zane rranje thelle ne te, qe te bahet i vetedijshem per to dhe qe ti bahen pjese perbase ne jeten e tij te perditshme, t'i bahen vete jeta.

Armata e jone ka qene, e asht edhe sot nji nga vendet e mbledhjes ma me randesi, ku riedukohen dhe krijohen njerez po me keto veti per te cilat fola. Partija e jone i ka kushtue perhere kujdes shum te madh edukimit t'ushtarve dhe oficerave. Ajo ka ngrite dhe nalteson ushtarin dhe udheheqsin, per te cilin besnikija dhe devocjoni ndaj vendit te vet te lavdishem, i cili po e nderton socjalizmin — asht mbi te gjitha. Ikja avanturjere dhe panike e trathtarve te tipit t'Arsa Jovanoviqit, te cilet ma pare, tue i çfrytzue ne menyra te ndryshme te gjitha dobesit e tyne — i kane demoralizue e mandej i kane sjelle ne nji qendrim dyftyrsh kundrejt Partis dhe i kane ba vegla qorre — provon se rranja e ketyne anmiqve nuk asht e thelle, se nuk kane muejte me qendrue gjate si te tille, me gjithse ne menyre te ndryshme jane shti se si pajtohen me Partin dhe me KQ. Ikja e tyne panike tregon se konsolidimi i armates dhe kompaktesija e Partis i shtrengojne me dale ne drite dyftyrshat e karjeristat. Kjo pune tregon fuqin t'one te mbrendeshme e jo-ligshtin. Shum nga njerzit t'one mendojne se keta dezertuesa e kane turpnue Armaten t'one. Por, ky mendim asht i gabueshem. Ata e kane turpnue vetem vehteveten dhe urdhendhanesat e tyne. Armata e jone asht armate revolucjonare anti imperjaliste, e ata qe punojne me e ligshtue — e ligshtojne ne te verteten, frontin e pergjithshem anti-imperjalist. Keshtu duhet me e shique ket çashtje dhe me luftue per konsolodimin edhe ma te forte t'Armates, per ngritjen politike e ideologjike dhe profesjonale te kuadrit te saje luftarak e komandues, tue shtue perbuzjen kundrejt atyne qe n'Armate kane hye vetem per arsye karjere dhe kane hjedhe poshte nderin dhe dinjitetin ushtarak, e kane shkele betimin dhe kane trathtue atdheun t'one socjalist dhe popullin t'one heroik.

Kongresi i Peste i Partis s'one, tue caktue rrugen e zhvillimit t'one dhe detyret t'ona, e armatose Partin me materjal te pasun ne lufte per edukimin ma te gjane dhe per ngritjen e njerezve t'one. Me njofte çdo njeri t'one puntuer, çdo antar te Frontit populluer me vendimet e Kongresit, me programin e Partis dhe me materjalin ma me randesi te Kongresit, me i ndihmue çe te tane ket materjal t'a kuptojne drejte dhe t'a pervehtesoje-qe kjo asht nji nga detyrat ma te para te çdo komunisti. Ky asht kushti i besimit te patrandun ne fitoren e socjalizmit ne Vendin t'one, kjo asht arme e fuqishme ne lufte per edukimin e drejte te popujve t'one.

Ketu qendron gjithashtu edhe randesija jashtzakonisht e madhe e Kongresit te Peste.

Shoke,

Nuk duhet as me dyshue se Partija e jone s'do te jete e zonja me realizue detyret e gusimshme, por reale qe i ka shtrue Kongresi i Peste. Nuk ka asafar shtrengese, nuk ka asafar fuqije qe mundet me e shmange KQ t'one dhe Partin t'one nga rruga e luftes per ndertimin socjalist, nga rruga e besnikis kundrejt doktrines se marksizem-lenjinizmit. Kongresi i Peste e ka provue ket fakt te pakundershtueshem para mbare botes e, praktika do t'a verteton gjithnji ma teper. E, na mund te jemi te sigurte se Partija e jone dhe turmat t'ona punnese, te mbledhuna rreth Frontit popullor, jo vetem qe do t'i kryejne te gjitha vendimet dhe programin e Partis, por, nen udheheqjen heroike dhe t'urte te Titos do t'i tejkalojne edhe shum detyra qe jane parashtrue sikurse jemi mesue edhe ne te kalumen.

Kolektivi punues i Trepçes dekorohet nga Qeverija e RFPJ me flamurin kalimtar dhe shperblehet me 700000 dinare

MITROVICE:

Simbas propozimit te Keshillit Qendruer te Sindikatave t'Unjisueme te Jugosllavis dhe te ministrave te sektoreve, Qeverija e RFPJ — ka prue ne keto dite vendimin per ndamjen e flamujve kalimtare kolektivave punojse ma te merituesheme, te cilat ne vjetin e dyte te Petoletkes s'one kane mbrrijte merita te jashtzakonshme ne kryemjen e detyrave te prodhimit.

Ndermjet shum kolektivave puntore ma te merituesheme te Vendit t'one, te cilave u jane nda flamujt kalimtare te Qeveris se RFPJ, gjindet edhe kolektivi punojs i minjeres dhe shkrijatores „Trepça". Bashke me flamurin kalimtar te Qeveris se RFPJ, kolektivit punojs te minjeres dhe te shkrijatores „Trepça" u asht dhane edhe shperblimi ne te holla prej 700.000 dinaresh.

Zveçan:

N'universitetin populluer te Zveçanit asht mbajte thema mbi randesin e vendimeve te Kongresit te Peste te PKJ. Themen e ka mbajte sekretari i komitetit te fabrikes dhe delegati i Kongresit te Peste te PKJ, Boro Tomiq. Ne theme kane asistue ma teper se 1000 puntore dhe nepunsa te fabrikes se Zveçanit.

—o—

Mitrovice:

Ma teper se 600 njerez punonjes nga Mitrovica kane asistue ne themen, te cilen e ka mbajte antari i Komitetit Krahinuer dhe delegati i Kongresit te Peste te PKJ Spasoje Gjakoviq. Themmbajtesi i ka njoftue interesisht ndigjuesit me vendimet e Kongresit te Peste te PKJ.

—o—

Peje:

Ne nderë te mbajtjes se Kongresit te Pare te sindikatave t'Unjisueme te Jugosllavis, fabrika e tullave dhe e tjegullave ne Peje i ka thirre per gara te gjitha fabrikat e tjera te tullave dhe te tjegullave ne Krahine. Ajo ka marre detyrimin se ne prodhim do t'a tejkaloje planin per 10 per qind.

Fushe - Kosova stacjon monoton per udhetaret

Ne Fushe Kosove asht satcjoni hekurudhor qe i lidhe jo vetem disa qendra te Kosmetit, por edhe mbare Krahinen me shum vise te vendit t'one — Serbin, Maqedonin etj.

Natyrisht neper kete stacjon kalojne me mija e mija njerez gadi per çdo dite e nate, te cilet shperndahen ne te gjitha anet e Vendit t'one. Kujt i ka ra me udhtue neper Fushe Kosove sigurisht asht ne gjendje me kallxue gjithshka çka ai ka konstatue e pa me syt e tij. Atje mu te shumten njerzit sillen ne kambe, derisa t'u vije koha me udhtue me trenat e ndryshem, mbasi nuk kane vend te pijne çaj a kafe se lene ma me drekue a me hanger darke.

Fushe Kosove, si stacjon hekurudhuer koq me randesi, nuk i mjafton as nji restorant i madh, prandaj duhet me ba ç'mos qe aty te kete vend-pushime te medha, te pasterta e moderne si dhe restorante te pershtatshme, ne te cilat te gjindet gjelle gjithmone kur kalojne trenat e kur udhetaret presin per disa ore rresht, sepse bukur shpesh trenat bajne vonesa te jashtezakonshme.

Asht mire qe mbrenda kesaj kohe te shkurte te bahet ç'mos per sigurimin e nji lokali te pershtatshem per restorant e kafe te paster, nderSa per ma teper pritet ne vitin e ardhshem.

Çka duhet te ndermeret per lokalet e shkollave fillore te rrethit te Podujeves

Keshilli Ekzekutiv Krahinuer Populluer i ka nda seksjonit arsimuer te keshillit populluer te rrethit ne Podujeve nji sasi te materjalit te gatshem per kryemjen e shkollave fillore ne Bajçine dhe Batllave. Perveç kesaj, seksjonit i asht nda edhe nji vagon binare per tavan dhe 20 metra kub drrasa te holla dhe te trasha. Por, seksjoni arsimuer i keshillit populluer te rrethit nuk i ka kushtue kujdesin e duhun perfundimit te ketyne shkollave, gja qe ma se miri e tregon fakti qe drrasat e ndame kane ndejte ma teper se 20 dite ne stacjonin e hekurudhes Prishtine, tue pritë qe t'i marre ndokush. Ne Batllave mungon gelqerja per lyemjen e shkolles, e kerkush deri me tash nuk ka marre kurrfare masash qe te gjindet gelqerja dhe te vazhdohen punet ne kryemjen e shkolles. Ne shkollat tjera te rrethit, gjithashtu, nuk jane fillue ende pregaditjet per vjetin e ri shkolluer.

Duhet te permiresohet sa ma pare furnizimi i popullsis me artikuj bujqesuer ne Ferizaj

Me gjithse ne shum vende te Krahines s'one ka fillue me u-permiresue furnizimi i popullsis punuese ne qytetin e Ferizajt ky asht ende i dobet, sipermarrjet furnizuese te qytetit nuk jane kujdesue qe te vijne ne lidhje me qendrat e prodhimit, me lidhe kontrata me'to dhe nuk kujdesohen per shfrytzimin e burimeve lokale. Ceshtjes se furnizimit me qumsht nuk i asht kushtue kurrfar kujdesi. Ne keto ditet e fundit asht fillue te furnizohet me qumsht vetem menza e puntorve dhe nepunsave, por edhe kjo jo me sasi te mjaftueshme.

Gjithashtu, edhe furnizimi me peme e perime nuk asht ne nalteson e duhun. Prandaj, asht e nevojshme qe organet pergjegjese per furnizim t'i marrin masat e duhuna per popullsinin e tij sa ma pare.

—o—

Furnizimi i popullsis ne Prizren asht permirsue mjaft

Ne keto dite asht permirsue mjaft furnizimi i popullsis se Prizrenit me artikuj te ndryshem bujqesuer. Deri me 25 te k.m. ndihej mungese e madhe per spec, domate, bostan, peme etj. Tash dyqanet jane plot me peme e perime. Sipermarrjet furnizuese te qytetit sjellin per çdo dite sasina te mjaftueshme pemesh e perimesh te freskëta. Ky permiresim asht rrjedhim i angazhimit ma te madh te kooperativave bujqesore per blemjen e tepricave te prodhimeve, e sidomos i kooperatives ne Krushen e Madhe.

—o—

Ne Gilan ndihet mungese per peme

Furnizimi i popullsis me artikuj bujqesuer, peme dhe perime ne Gilan nuk asht organizue ende ashtu si duhet. Ne qytet egzistojne vetem tri dyqane, qe merren me shitjen e pemeve dhe perimeve. Ceshtja e furnizimit me tambel nuk asht zgjidhe fare. Tash se voni furnizimi me perime ne Gilan te bahet nga kopshti shteteror ne Vitine. Megjithate, ndihet mungese e madhe per peme.

Organizatat e FAG-ut te rrethit te Prishtines jane tue perpunue materjalin e Kongresit te Peste te PKJ

PRISHTINE:

Keshilli i rrethit i Frontit Antifashist te Grave te rrethit te Graçanices ka mbajte nji seminar te shkurte me te gjithe udheheqesat e organizatave themelore te FAG-ut. Nder seminare jane perpunue vendimet e Kongresit te Peste te PKJ. Me anen e ketyne seminareve kryetaret dhe sekretaret e organizatave themelore te FAG-ut te rrethit te Graçanices jane njofte me detyrat themelore, te cilat Kongresi i Peste i PKJ i ka vue para Partis dhe populit ne lidhje me ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Ato ne teren do t'i njoftojne te gjitha grate me vendimet dhe detyret, te cilat i ka prue Kongresi i Peste.

Prizren:

Per qellim te ngritjes ideo-politike t'antarve te Frontit, seksjoni per agitacjon dhe shtyp prane keshillit te qytetit ne Prizren, ka organizue themen me randesi mbi vendimet e Kongresit te Peste te PKJ. Themen ne te cilen kane asistue afro 600 antare te Frontit, e ka mbajte antari i keshillit te qytetit te Frontit populluer Dushan Sheshoviq. Ai ka parashtrue perfundimet e Kongresit te Peste te PKJ, punen e tij dhe zgjedhjen e udheheqjis se re te Partis.

Gilan:

Ne Gilan asht formue brigada e punes e perhame nga 115 antare te Frontit populluer, e cila me 25 te muejit te kaluem ka shkue ne vendpunimin e caktuem, ku do te punoje ne hapjen e rruges Rudare-Prokuplje (Prolliam, Serbi), me anen e se cilës do te transportohet landa e pyjeve te shumta t'atij vendi. Brigada nuk asht kompletue me numrin e parapare per shkak se asht fillue vone organizimi dhe formimi i saje dhe per shkak t'aggitacjonit te dobet.

—o—

Afer 10.000 kg. lemask jane tue shkue dam

Para sa kohe ne rrethin e Gilanit jane ble me çmime te lartë afer 10.000 kg. lemashk. E gjithe kjo sasi gjindet edhe sot neper kooperativat shit-blemse dhe i kercnohet rreziku me u-dam (ma fare nga lagështia), mbasi asht vendose neper vende te papershtatshme. Bashkimi kooperativ i rrethit nuk e ka marre ne dorzim per shkak se i mungon ambalazhi. Asht mire qe te merren masat e menjihershme per me e transportue ketë sasi lemashku ku duhet dhe me e evitue damtimin e tij.

Lajme nga bota

Rober Shumani e formoi qeverin e re franceze, e cila asht perfaqesuese e interesave amerikane

PARIS:

Rober Shumani perseri e formoi qeverin. Qeverija e mapareshme e Andre Maris, qe u-formue mbas qeveris s-pare te Shumanit, pat nji jete te shkurte prej nji muej. Qeverija e tashme, nga e cila u-nxueren perfaqesuesit e Partis Komuniste, perseri perbahet prej socjalistave te Blumit.

Perveç Rober Shumanit, i cili e mbajti resorin e ministris se puneve te jashtme, ne qeveri si nenkryetar hyeni edhe kryetari i qeveris se mapareshme radikal-socialisti Andrej Mari.

Per te gjitha keto, si çfaqje kundershtimi bahen greva dhe mitingje protestuese ne gjithe Francen. Ne te gjitha keto mitingje mueren pjese nga disa mija puntore, te cilet kerkojne formimin e nji qeverije demokratike.

Sh. B. A. e konsiderojne Italin si [illegible] koloni te veten

ROME:

Agjensija «Tas» lajmon: Udheheqesi i misionit amerikan n'Itali, Xhems Zellerbahu, mbajti nji fjalim ne Milano, ne te cilin theksoi se Italija konsiderohet si koloni e pasun amerikane, e cila ka ne dispozicion „fuqi te vleshme puntore".

„Si ndihme amerikane ne forme te huas mund te llogariten vetem ato dege t'industris italiane — shtoi ma ne fund Zellerbahu — te cilat do te jene ne gjendje qe te zhvillohen si pjese e tanesis ekonomike, e cila do te perfshine mbare Europen."

Ushtaret e brigades monarko-fashiste refuzuen qe te luftojne kundër Armates Demokratike.

ATHINE:

Radjostacjoni i Greqis se lire lajmon se njsit e Armates Demokratike me 4 te keti muej i thyen te gjitha sulmet e armikut ne Maqedonin e Egjeut. Dihet se ka plase kryengritje ne brigaden 43 monarko-fashiste ne sektorin Ieropili. Ushtaret refuzuen qe te luftojne matutje kundra Armates Demokratike, keshtu qe monarko-fashistat u-detyruen me sjelle fuqi te reja. Njsit e Armates Demokratike i thyen te gjitha sulmet e armikut.

Vala e grevave te njerzeve punues te Japonis kunder politikes qeveritare anti-puntore.

TOKIO:

Agjensija „Tas" lajmon: Fletoria «Akohata» shkruen se as burgosjet masovike nuk po munden me e ndale levizjen e protesteve ne Japoni, e cila ka shperthye me rastin e urdhneses per revizjonin e ligjit mbi sherbimin shteteror dhe publik. Shum sindikata kane protestue kunder shtypjes se levizjes puntore.

HAMBURG:

Cenzura e organeve te pushtetit okupues britanik e ndaloi daljen e fletores perparimtare „Fallkscaitung", qe dilte ne Hamburg (zona okupuese e Britanis) tue mos e aragtue me burgjia ket mase.

PRAGE:

Organet e sigurimit shteteror e zbuluen dhe e burgosen nji grup priftnash katolike, te cilet n'aferi te kufinit austriak organizuen qendren per kalimin e t'ikurve ne boten e jashtme.

Ne Berlin u-formue bloku demokratik per luften kunder politikes reaksjonare te drejtoris se qytetit

BERLIN:

Korespondeti i „Tanjugut" lajmon:

Dje ne Berlin u-formue bloku demokratik, ne te cilin hyen organizatat e Berlinit te partis Unike socjaliste dhe te pjeses perparimtare t'Unionit Kristiano-Demokratik dhe te Partis Liberale-Demokratike, bashkimi i sindikatave te lira gjermane dhe grupi social-demokrat, i cili e kundershton politiken e Shumaherit, qe i tradhton interesat puntore.

Bloku demokratik ka si detyre kryesore ruajtjen e interesave te popullsis se Berlinit ne lufte kunder politikes reaksjonare te drejtoris se qytetit te Berlinit.

Ndersa standardi jetesuer i popullit amerikan bje ne dekadence, kompanit'e mbrrijne fitime rekordi

NEW-JORK:

Korespondenti i „Tanjugut" lajmon:

„Deili Vorker" transmeton lajmin e Komisionit Federal Amerikan per tregti dhe komisionit per letra, simbas te cilit fitimet e kompanive amerikane ne tremuejshin e pare te vjetit 1948 jane ma te medha per 7,9 perqind se ne periudhen e njajte te vjetit te kaluem, ndersa ne krahasim me tremuejshin e fundit te vjetit 1947 fitimet jane rrit per 12,5 perqind. Keto fitime rekordi jane ba edhe nga shkaku qe shuma e pergjithshme e blemjes gjate ketij vjeti asht zbrite per 1 miljarde dhe 100 miljone dollare.

Ne shtetet prendimore te SH.B.A. 16.000 puntore vojgurore kane ba greve

SAN FRANCISKO:

„Asoshieted pres" lajmon se mbas deshtimit te marreveshjes per rritjen e mëditieve, bane greve 16.000 puntore vojgurore, antare te sindikatave.

Sindikata e puntorve t'elektrikut ne Londer kerkon terhekjen e trupave britanike nga Malaj.

LONDER:

Korespondenti i «Tanjugut» lajmon:

Simbas lajmeve te «Deili Vorkerit», keshilli krahinuer i sindikatave te puntorve t'elektrikut te Londres i dergoi keshillit ekzekutiv te sindikatave, te puntorve t'elektrikut dhe ministrit te punve te jashtme, Bevinit, rezolucion me te cilen kerkohet qe trupat britanike te terhiqen nga Malaja.

Ndertimi I shtepijave kooperative ne rrethin e Gilanit

Ne rrethin e Gilanit vazhdojne punimet per ndertimin e te gjitha shtepijave te parapame me plan e ka edhe per ndertimin e kater shtepijave tjera jasht planit. Deri tash jane mbarue shtepijat kooperative ne Malisheve, Tripce e Pozheranj e asht tue u mbarue ne Lenide. Drejtorija e rrethit per ndertimin e shtepijave kooperative duhet t'i kushtoje nji kujdes ma te madh punes ne teren dhe te jepin ndihmen e nevojshme aty per [illegible].

Kurs per llogaritar industrije

Ne keto dite asht organizue ne Odim nji kurs per llogaritare te sipermarrjeve industrijale. Ne kete kurs do te marrin pjese 80 nxanes nga vendet e ndryshme te Kosmetit. Kursi do te vazhdoje dy muej. Kursistat do te perfitojne jo vetem dijeni profesjonale te llogaris por edhe me dhe te kulturës se pergjitheshme. Ne kurs japin mesime edhe tre profesora ta deget, t'ardhun nga Beogradi. Mbas mbarimit te kursit te gjithe nxanesit qe do te kryejn sukses, do t'emnohen per llogaritar prane sipermarrjeve industrijale te Krahines s'one.

Antaret e frontit ne Koçaçevç te Kaçanikut ndertojne shkollen fillore

Antaret e Frontit populluer te katundit Kovaçevc te keshillit te vendit Kaçanik me iniciativen e vet kane fillue me e ndertue shkollen fillore ne katundin e vet. Ne kete ndermarrje u ka dhane ndihme te madhe edhe udheheqja e keshillit te vendit te Frontit populluer.

Ngritja e mureve ka marre fund. Per transportimin e gurve kane punue 300 pende kafshe terheqese. I gjithe materjali i nevojshem asht sigurue nga burimet e vendit dhe pjesa tjeter asht ble me çmimin e zakonshëm. Me anen e keshillit te vendit te Frontit populluer jane sigurue ma se 10.000 copë tulla dhe 5000 [illegible]. Perveç punes vullnetare, antaret e Frontit kane mbledhe edhe 25.000 dinare ne te holla. Tash asht tue vazhdue puna per ngritjen e kulmit. Ndermjet[illegible] [illegible] [illegible] [illegible].

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miliadin Popoviq" Prishtine.
Pajtimet ne llogaren e pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.